

RAPORT I VEÇANTË I MBROJTËSIT TË QYTETARËVE
PËR
PËRDORIMIN ZYRTAR TË GJUHËS DHE SHKRIMIT SHQIP



Заштитник грађана

Botues
Mbrojtësi i qytetarëve (Ombudsmani)

Për botuesin
Olja Joviçiq

Redaktor
Robert Sepi

Tirazhi
100 ekzemplarë

Viti i botimit
2018

ISBN 978-86-87945-44-9

Faqësja dhe shtypi



RAPORT I VEÇANTË I MBROJTËSIT TË
QYTETARËVE
PËR PËRDORIMIN ZYRTAR TË GJUHËS DHE
SHKRIMIT SHQIP

Janar, 2018..

*Raporti është përgatitur me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Serbi.
Pikëpamjet e shprehura në raport i përkasin ekskluzivisht autorëve dhe nuk
përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Misionit të OSBE-së.*



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Serbi

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE.....	7
HYRJE.....	9
GJUHA DHE SHKRIMI SHQIP NË KOMUNAT NË TË CILAT ËSHTË NË PËRDORIM ZYRTAR	12
Komuna e Bujanocit	12
Komuna e Preshevës	15
REGJISTRIMI ELEKTRONIK I LINDJES SË FËMIJËS.....	19
E DREJTA PËR ZGJEDHJEN DHE PËRDORIMIN E EMRIT PERSONAL NË GJUHËN SHQIPE DHE SIPAS DREJTSHKRIMIT TË SAJ NË TERRITORIN E VETËQEVERISJEVE LOKALE NË TË CILAT GJUHA SHQIPE NUK ËSHTË NË PËRDORIM ZYRTAR	21
Qyteti i Vranjës	21
Qyteti i Leskocit	23
Qyteti i Nishit.....	25
KONKLUZIONE	28
REKOMANDIMET	30
SHTESA 1.....	32
SHTESA 2.....	38

PËRMBLEDHJE

Përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare

- e drejtë e secilit person është që në çdo procedurë para organit dhe organizatës, që duke ushtruar autorizimet publike vendosin mbi të drejtat dhe detyrimet e tij, të përdor gjuhën e tij dhe në procedurë të njihet me faktet në gjuhën e vet*
- shenimi i emërtimeve topografike në gjuhët e pakicave kombëtare*
- e drejta për të zgjedhur lirshëm dhe për të përdorur emrin personal dhe emrat e fëmijëve të tyre, si dhe për regjistrimin e emrit personal në të gjitha dokumentet publike, në evidencat zyrtare dhe koleksionet e të dhënave personale sipas gjuhës dhe shkrimit të pjesëtarëve të pakicave kombëtare*
- lëshimi i dokumenteve publike dhe mbajtja e shënimeve zyrtare dhe koleksioneve të të dhënave personale në gjuhët e pakicave kombëtare dhe pranimi i këtyre dokumenteve publike, në ato gjuhë si ligjërish të vlefshme*

E drejta e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit është njëra nga të drejtat më të rëndësishme, për shkak të një sërë arsyes, të cilat iu garantohen pjesëtarëve të pakicave kombëtare me akte ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare. Kur kjo e drejtë konsiderohet si çështje e kornizës ligjore, mund të konstatohet se Republika e Serbisë ka miratuar dispozita ligjore që parashikojnë dhe garantojnë ushtrimin e saj në përputhje me aktet dhe standardet më të larta ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, nuk mund të mohohet fakti se ka ende shembuj nga praktika, si dhe nga procedurat e kontrollit që i ka bërë Mbrotjtësi i qytetarëve, probleme në lidhje me zbatimin e saj të plotë dhe efikas. Për më tepër, rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë një gjë - se problemet / shkeljet e të drejtave të qytetarëve në mënyrë të barabartë ekzistojnë si në vetëqeverisjet lokale ku gjuha dhe shkrimi i pakicave kombëtare është futur në përdorim të barabartë, ashtu edhe në ato vetëqeverisje lokale ku kjo nuk është rast. Ato kanë si pasojë një pakënaqësi të justifikuar të qytetarëve të cilëve ajo u është shkelur në atë mënyrë.

Parakushtet për ushtrimin e kësaj të drejte ka kohë që njihen – kapacitetet e kuadrove, mundësitë financiare si dhe kushtet teknike. Derisa mungesa e tyre mund të kuptohet si një pasojë logjike në ato vetëqeverisje lokale ku gjuha dhe alfabeti i pakicës nuk janë futur në përdorim zyrtar, pakënaqësi të qytetarëve shkakton fakti se ato nuk ekzistojnë edhe aty ku gjuha dhe shkrimi janë në përdorim të barabartë zyrtar. Përveç kësaj, si një nga hapat kyç për realizimin efektiv dhe të plotë të së drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare, përmes studimit të bërë edhe një herë është imponuar reaçizimi i të drejtës për informim. Duke parë individualisht, hapi i parë, që si një temë e hulumtimit fitoi një vend qendror në këtë tekst, është realizimi i së drejtës për emrin personal, regjistrimi i tij në evidencat publike në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare si dhe lëshimin e dokumenteve në të cilat emri personal është i shkruajtur në atë gjuhë dhe shkrim.

HYRJE

Pjesëtarët e komunitetit kombëtar shqiptar theksojnë me vite se në Republikën e Serbisë nuk është siguruar realizimi i të drejtës për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip në mënyrën e përcaktuar me dispozita ligjore. Situata kohëve të fundit deridiku është përmirësuar, siç dëshmohet nga zbatimi i disa rekomandimeve të Mbrojtësit të Qytetarëve si dhe aktivitete dhe masa të ndryshme të cilat i kanë ndërmarrë organet kompetente në fushën e përdorimit zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve. Përkundër kësaj, procedurat e kryera para këtij organi tregojnë se ende ekziston një pakënaqësi e justifikuar e qytetarëve lidhur me ushtrimin e së drejtës për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip.

Për këtë arsye, Mbrojtësi i qytetarëve ka përgatitur këtë raport me qëllim që të përcaktojë situatën reale dhe të tregojë arsyet pse në praktikë ende ekzistojnë probleme në përdorimin e barabartë zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip, si në komunat ku kjo gjuhë është në përdorim të barabartë zyrtar, siç janë Bujanoci dhe Presheva, ashtu edhe në komunat ku nuk është kështu, si në Vrajë, Leskoc dhe Nish. Duke pasur parasysh natyrën e punës së Mbrojtësit të Qytetarëve (Ombudsmanit) si një organ kontrolli dhe korrektimi, në Raport gjithashtu propozohen edhe masat për të eliminuar pengesat për zbatimin konsekuent të ligjit.

Në të njëjtën kohë, në shtesat e raportit është dhënë një pasqyrë e procedurave që janë bërë nga ana e Mbrojtësit të qytetarëve për mbrojtjen e të drejtës së përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip, të cilat në mënyrë të qartë tregojnë se shkaqet e problemit janë sistematike, prandaj me eliminimn e tyre përmirësohet i gjithë sistemi i mbrojtjes dhe ushtrimit të të drejtave të përdorimit të të gjitha gjuhëve të pakicave që kanë hyrë në përdorim zyrtar në Republikën e Serbisë.

Çështja me rëndësi esenciale për ruajtjen e identitetit të pjesëtarëve të pakicave kombëtare me të cilat Mbrojtësi i qytetarëve është marrë në mënyrë të veçantë në hulumtim është e drejta për emrin personal. E drejta për emrin personal është një nga të drejtat e ngritura në nivelin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Kushtetuta e Serbisë proklamon se zgjedhja dhe përdorimi i emrit personal dhe të fëmijëve

të tyre është e lirë. Për pjesëtarët e pakicave kombëtare, Kushtetuta përmban një garanci shtesë për të drejtën e përdorimit të emrit dhe mbiemrit në gjuhën e vet.

E drejta për emrin personal është e drejtë njerëzore që duhet t'i mundësojë çdo qenieje njerëzore të ushtrojë të drejtën e identitetit dhe mbrojtjen e tij. Me qëllim që përfaqësuesi i pakicës kombëtare të realizojë të drejtën për regjistrimin e emrit personal në letërnjoftim, në formën burimore, është e nevojshme të paraqes çertifikatën e lindjes dhe vërtetimin e shtetësisë, në të cilët emri personal është regjistruar edhe në formën e saj burimore, si dhe shprehimisht të kërkojë që në formularin e letërnjoftimit, t'i shenohet emri personal në formën e tij burimore. Prandaj, regjistrimi i emrit personal në formën e tyre burimore në librat e amzës, parasegjithash të të lindurve, paraqet bazën për realizimin e të drejtës për shenimin e emrit personal në letërnjoftim, si dhe në dokumentet tjera publike dhe evidencat zyrtare. Projekti "Bebush, mirë se erdhe në botë" bëri të mundur që institucionet shëndetësore që janë të pajisura teknikisht për zbatimin e sistemit të regjistrimit elektronik të lëshojnë fletëregjistrimin e lindjes së fëmijës, në formën dhe mënyrën e përcaktuar me aktin nënligjor.

Regjistrimi elektronik i lindjes është një formular në bazë të të cilit bëhet regjistrimi i faktit të lindjes së fëmijës në librin amzë të të lindurve në institucionin shëndetësor dhe regjistrimi i të dhënave për emrin personal në librin amzë, duke përfshirë edhe gjuhën edhe sipas drejtshkrimit të gjuhës së pakicës.

Raporti shqyrton edhe nivelin e trajnimit të punonjësve të shëndetësisë për të bërë aplikimin e regjistrimit elektronik, si dhe problemet me të cilat ballafaqohen ata në këtë proces. Pasi që projekti „Bebush, mirë se erdhe në botë“ ende është në fazat e hershme të zbatimit, është e këshillueshme që sa më parë të identifikohen dhe të zgjidhen problemet që po ndodhin në terren.

Praktika e gjertanishme e regjistrimit në librin amzë, qoftë përmes shërbimit të gjendjes civile, ose të regjistrimit të ri elektronik, ka treguar se ka probleme në regjistrimin e saktë në librat amzë të të lindurve sipas drejtshkrimit të gjuhës dhe shkrimit shqip. Njëri nga gabimet më të shpeshta është se regjistrimi paralel në alfabetin latin, por jo edhe sipas drejtshkrimit të gjuhës shqipe, konsiderohet si regjistrim dygjuhësor.

Duke u nisur nga fakti se shteti është i obliguar që të sigurojë kushtet kadrovike, financiare dhe teknike për realizimin e së drejtës për

përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve të pakicave kombëtare, si dhe përzgjedhjen dhe përdorimin e emrit personal sipas gjuhës dhe drejtshkrimit të pakicës të cilës i përket, raporti synon të nxjerrë në pah masat që duhet të ndërmerren në mënyrë që të eliminohet çdo mundësi që me punën e punonjësve shëndetësorë të ngarkuar për plotësimin e regjistrimit elektronik të bebes së lindur, të shkelet e drejta e prindërve për të zgjedhur që emri personal i fëmijës të regjistrohet ligjërisht dhe në mënyrë të rregullt në bazë të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Për të vërtetuar të gjitha faktet, Mbrojtësi i qytetarëve, në një situatë kur ka patur në dispozicion informata të ndryshme mbi ushtrimin e së drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip, ka bërë vizita në vetëqeverisjet relevante lokale. Gjatë vizitës në komunat Bujanoc dhe Preshevë, janë bërë biseda me kryeshefat e administratave komunale, përfaqësuesit e shërbimeve kompetente si dhe me përfaqësuesit e Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare shqiptare. Janë parë edhe librat amzë të të lindurve, si dhe vendimet e sjellura në procedura të ndryshme administrative nga ana e organeve komunale. Para së gjithash, u kërkuan përgjigjet për mosveprimet në punën e vetëqeverisjeve lokale të lartpërmendura, të cilat ishin objekt i procedurave të mëparshme të kontrollit të këtij organi. Përveç kësaj, shikimi i drejtpërdrejtë i mbishkrimeve të vendosura publike ishte i vlefshëm për të përcaktuar situatën reale në këtë fushë.

Duke pasur parasysh se vlerësimi real i atyre që e dinë se pjesëtarët e pakicës kombëtare shqiptare përdorin shërbimet e materniteteve që janë më afër komunave në fjalë, janë bërë biseda edhe me kryeshefat e administratave të qyteteve si dhe të shërbimeve të gjendjeve civile të qyteteve Vranjë, Leskovc dhe Nish. Edhe aty janë shikuar librat amzë, e në veçanti janë shikuar regjistrimet e emrit personal në gjuhën dhe shkrimin shqip, si dhe në sistemin Qendror për mbajtjen e librave amzë në formën elektronike. Në maternitetet e këtyre qyteteve është biseduar me personat të cilët, në atë kohë, ishin përgjegjës për regjistrimin elektronik të të porsalindurve. Kjo qasje e bëri të mundur grumbullimin e të gjithë informatave të nevojshme për të përcaktuar situatën faktike të justifikuar dhe për propozimin e masave për përmirësimin e saj.

GJUHA DHE SHKRIMI SHQIP NË KOMUNAT NË TË CILAT ËSHTË NË PËRDORIM ZYRTAR

Komuna e Bujanocit

Shikuar në raport me konkluzionet dhe njohuritë e mëhershme Mbrojtësi i qytetarëve për lëshimet në punë, Komuna e Bujanocit e ka përmirësuar mbrojtjen dhe realizimin e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip, që është vendosur me Statut në përdorimin e barabartë zyrtar me gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik.

Avansimi fillimisht pasqyrohet në faktin se është siguruar dygjuhësia gjatë hartimit të akteve zyrtare, dhe e kjo është veçanërisht e dukshme tek mbishkrimet publike. Gjithashtu, duke pasur parasysh atë që regjistrimi i të dhënave për emrin personal është i rregullt dhe ligjor në të dy gjuhët dhe shkrimet që janë në përdorim zyrtar në komunë, Mbrojtësit të qytetarëve nga administrata komunale i është thënë se nuk ka pasur probleme dhe parregullsi në listat e votuesëve.

Është e rëndësishme të theksohet se, megjithë kufizimet e buxhetit lokal, tabelat me emrat e rrugëve janë bërë në dy gjuhë dhe pastaj janë zëvendësuar të deritatëhershmet. Duke pasur parasysh faktin se për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe shkrimit në nivelin lokal nevojiten mjete të konsiderueshme, nga administrata komunale Mbrojtësit të qytetarëve i është konfirmuar se shërbimi përkatës dhe mjetet nga buxheti i Republikës do të kontribuonin ndjeshëm që të zbatohet ligji vazhdimisht dhe në mënyrë efektive. Në një situatë kur vetëqeverisjet lokale nuk kanë mjete për të zëvendësuar të gjitha tabelat, pa ndihmën financiare të Republikës së Serbisë, zëvendësimi i tabelave zgjat disa vite.

Ende është problem aktual numri i përkthyesve të nevojshëm dhe të angazhuar për gjuhën shqipe në administratën komunale, veçanërisht tani në kontekstin e ndalimit të punësimit. Hartimi i akteve ligjore kërkon përkthyes profesional, kështu që edhe pse janë tre përkthyes, vetëm një është profesionalist i cili duhet të kontrollojë edhe aktet e dy përkthyesve të tjerë.

Lidhur me këtë, duhet theksuar se gjatë vizitës në komunën e Bujanocit është vërejtur se ende nuk janë siguruar tabelat dygjuhësore të filialave / degëve të organeve shtetërore të republikës, në gjuhën dhe shkrimin serb dhe shqip. Ndër të tjera, edhe tabela me emrin e Qendrës për kadastër të patundshmërive Vranjë, Shërbimi i kadastrës së patundshmërive në Bujanoc është e shenuar vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik. Gjithashtu, edhe tabela me emërtimin e Ministrisë së financave, Administrata tatimore, Filiala në Bujanoc nuk është në dygjuhë, përkatësisht është e shenuar vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik.

Pas hulumtimeve të mëparshme nga ana e këtij organi, Enti republikan i gjeodezisë si dhe Administrata tatimore, në bashkëpunim të ngushtë me Mbrojtësin e qytetarëve, si dhe organet tjera republikane, kanë marrë për obligim që të planifikojnë mjete dhe të ndërrojnë tabelat në mënyrë që të shkruhen në përputhje me ligjin, në vetëqeverisjet lokale ku gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim të barabartë zyrtar. Për fat të keq, hulumtimi i fundit ka treguar se në kohën e vizitës në komunën e Bujanocit kjo ende nuk është bërë.

Mbrojtësi i qytetarëve (Ombudsmani), pas punës në terren, i'u drejtua Entit republikan të gjeodezisë dhe Administratës tatimore me qëllim të mbledhjes së informatave për cilat arsye tabelat ende nuk janë shkruajtur në pajtim me ligjin, përkatësisht në gjuhën serbe dhe shqipe.

Pas marrjes së shkresave, Ministria e financave, Administrata tatimore, ka marr masa dhe ka siguruar tabelat dygjuhësore për nevojat e Filialës në Bujanoc, të cilat janë vendosur më 29 shtator të vitit 2017-të, dhe për këtë gjë Mbrojtësin e qytetarëve e ka njoftuar edhe Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare.

Megjithatë, Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare ka bërë me dije, se edhe pse janë ndryshuar tabelat në ndërtesën e Komunës së Bujanocit, ku ndodhet selia e Administratës tatimore, Filiala në Bujanoc, në hapësirat e brendshme e Filialës tabela ende është vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik.

Enti republikan i gjeodezisë ka marr masa duke urdhëruar Drejtorinë e prokurimit publik që për vitin e ardhshëm të planifikojë në planin e prokurimit edhe tabelat dygjuhësore. Megjithatë, Mbrojtësi i qytetarëve shfrytëzon edhe këtë mundësi që edhe një herë të theksojë obligimin ligjor për vendosjen e tabelave dygjuhësore, për të cilën gjë Entin republikan të gjeodezisë e ka njoftuar që para më shumë se 6 vitesh, por që ende nuk është vepruar dhe as nuk është siguruar zbatimi konsistent i ligjit.

Përkundrazi, inkurajojnë gjetjet e Mbrojtësit të qytetarëve të vërtetuara në bazë të informatave gjatë shikimit të librave amzë në komunën e Bujanocit. Gjatë shikimit u konstatua se librat amzë udhëhiqen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të cilat rregullojnë këtë çështje. Gjithashtu është konstatuar, se në shërbimin e ofiqarisë është theksuar njoftimi mbi të drejtën e qytetarëve për të paraqitur kërkesën për korrigjimin e të dhënave në evidencat e gjendjes civile, përkatësisht në gjuhën shqipe dhe sipas drejtshkrimit të asaj gjuhe. Në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, emrat janë dhënë nga origjinali, përkatësisht siç janë shkruajtur në librat amzë.

Përfaqësuesit e Këshillit kombëtar të pakicës kombëtare shqiptare kanë theksuar se çështja e zgjedhjes dhe përdorimit të emrit personal në gjuhën dhe drejtshkrimin shqip ende është aktual, duke pasur parasysh se të gjitha regjistrimet e mëhershme në librat amzë ishin në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, dhe se qytetarët ende nuk janë të informuar në mënyrë të mjaftueshme për të drejtën e paraqitjes së kërkesës, me qëllim që më vonë të bëhet regjistrimi i emrit personal në librin amzë të të lindurve edhe në gjuhën shqipe dhe drejtshkrimin e asaj gjuhe.

Prandaj për këtë, Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare ka bërë një fushatë mediatike disa mujore me qëllim të informimit të qytetarëve për të drejtat e tyre dhe mënyrën e ushtrimit të së drejtës për të regjistruar emrin personal në regjistrat publikë në gjuhën dhe shkrimin shqip.

Gjatë hulumtimit, si shkak i problemit, paraqitet fakti se gjuha shqipe përmban një numër më të madh shkronjash që nuk i njeh alfabeti dhe drejtshkrimi serb, kështu që shqiptimi i emrit personal nuk është i njëjtë me mënyrën si si shkruhet në gjuhën dhe drejtshkrimin shqip. Kjo mund të ketë për pasojë që emrat të shkruhen në gjuhën serbe dhe shkrimin latin, ashtu si që e “dëgjon” dhe e kupton personi që e shkruan, çka nuk është është as e ligjshme, as e rregulltë dhe shkel të drejtën e qytetarëve në identitet, pjesë përbërëse e të cilit është emri personal.

Në këtë kuptim, ekziston një propozim që hartimi i katalogut me emrat më të zakonshëm shqiptarë, që do të ishte një instrument ndihmës i punonjësve të gjendjes civile, mund të evitojë problemet e përmendura.

Gjatë një vizite pune në komunën e Bujanocit, ku gjuha dhe shkrimi shqip janë në përdorim të barabartë zyrtar, në administratën komunale dhe bashkëbiseduesit e tjerë deklaruan se në Gjykatën Themelore në Bujanoc “nuk ka asnjë përkthyes zyrtarisht të punësuar, se nuk kanë

njohuri se si bëhen aktet zyrtare edhe në gjuhën dhe shkrimin shqip dhe se rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në gjykatën e përmendur nuk ka parashikuar punësimin e një përkthyesi.”

Për të siguruar që të dhënat dhe të gjeturat në Raportin e vacantë të Mbrojtësit të qytetarëve të mos jenë të diskutueshme, me këtë rast i është dërguar shkresë Ministrisë së Drejtësisë me qëllim të mbledhjes së informacioneve.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë dhe në bazë të dokumentacionit të paraqitur, këto pohime nuk janë të bazuara, sepse me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në gjykatën në fjalë është sistematizuar vendi i punës përkthyesi i gjykatës me 3 (tre) të punësuar si vendin e punës përkthyesi i gjykatës me 1 (një) të punësuar, për kryerjen e përkthimeve në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

Komuna e Preshevës

Pas një hulumtimi të kryer në komunën e Preshevës, Mbrojtësi i qytetarëve (Ombudsmani) ka konstatuar disa përparime në lidhje me përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj edhe në komunën e Preshevës.

Ashtu si në komunën e Bujanocit, Mbrojtësi i qytetarëve ka vërtetuar se tabelat me emërtimet e organeve të Republikës nuk ishin bërë sipas ligjit në komunën e Preshevës, ku gjuha dhe shkrimi shqip janë në përdorim zyrtar.

Fatëkeqësisht, tabelat me emërtimet e organeve të Republikës ende nuk janë zëvendësuar ose nuk janë siguruar tabela dygjuhësore të filialave / degëve të organeve shtetërore të Republikës, në gjuhën dhe shkrimin serb dhe shqip, edhe pse Mbrojtësi i qytetarëve tërhoqi vërejtjen për këtë lëshim disa vite më parë dhe atëherë ishte shprehur i mire se do të hiqet.

Duke pasur parasysh këtë, Mbrojtësi i qytetarëve edhe kësaj here iu drejtua Ministrisë së Financave, Administratës tatimore si dhe Entit republikan të gjeodezisë. Veprimi i këtyre organeve është i njëjtë sikur në rastin e komunës së Bujanocit.

Më saktësisht, Administrata tatimore ka informuar Mbrojtësin e qytetarëve se janë porositur tabelat edhe për nevojat e ekspoziturës së Preshevës edhe në gjuhën dhe shkrimin shqip, të cilat janë vendosën në fund të shtatorit.

Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare ka shprehur kënaqësinë që më në fund një gabim i tillë u eliminua përfundimisht. Aq më tepër, përfaqësuesit e Këshillit kombëtar të pakicës kombëtare shqiptare kanë vërë në dukje se, për dallim nga komuna e Bujanocit, janë zëvendësuar tabelat si në hyrje të ndërtesës, ashtu edhe në ambientet e brendshme të komunës së Preshevës.

Në rastin e Entit republikan të gjeodezisë, tabelat me emërtimet e organeve, Shërbimi i kadastrit të patundshmërive në Vranjë, tabelat ende nuk janë zëvendësuar, dhe sipas përgjigjes së dorëzuar është urdhëruar që zëvendësimi i tabelave të përfshihet në planin e prokurimit për vitin e ardhshëm.

Avansimi në punën e Administratës komunale në Preshevë, është vënë re edhe në lidhje me sjelljen e vendimeve në dy gjuhë, por vetëm në disa raste, për shembull, te kontratat e punës të të punësuarve e shërbimet komunale, që më herët nuk kishte ndodhur, sipas gjetjeve të Mbrojtësit të qytetarëve të gjatë hulumtimit për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit që u bë në vitin 2010-të.

Mbrojtësi i qytetarëve me këtë rast thekson shqetësimin se regjistrimi i emrit personal në librin amzë të të lindurve edhe më tej bëhet vetëm në gjuhën dhe shkrimin shqip. Problemi lind sepse në aplikacionin qendror, ku janë të përkthyer librat amzë të të lindurve nuk mund të regjistrohen në mënyrë të regullisht në gjuhën dhe shkrimin shqip, përkatësisht në aplikacion shkruhet vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik.

Kjo mandej për pasojë ka gabime të mëdha, gjatë zgjedhjeve, sepse gjatë transkriptimit të emrave personal nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik (psh. SH në CX) këta emra personal të qytetarëve shënohen gabimisht në listën zgjedhore.

Për shkak të transkriptimit të pasaktë, nuk është e mundur të gjenden qytetarët në listën zgjedhore, emrat e të cilëve janë futur edhe në gjuhën dhe drejtshkrimin shqip në qoftë se nuk posedojnë letërnjoftimin me emrin personal të shenuar në të njëjtën mënyrë, por vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik. Në anën tjetër, kur çertifikata është dygjuhësore, të dhënat futen në mënyrë rregulltë.

Prandaj, edhe në këtë rast është propozuar mundësia e hartimit të katalogut të emrave që do t'i lehtësonte punën ofiqarëve, veçanërisht në situatën kur te ofiqari vjen pala që nuk e njih mirë gjuhën serbe dhe si pasojë ka vështirësi në komunikim. Nga administrata komunale

është theksuar se në internet ekzistojnë listat e emrave dhe mbiemrave shqiptarë, por këto nuk janë dokumente zyrtare që mund të përdoren nga organet kompetente, por listën zyrtare mund ta formojë Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare.

Sipas deklarimeve të përfaqësuesve të komunës së Preshevë, për qytetarin është e rëndësishme që emri të shkruhet saktë në gjuhën shqipe, ndërsa transkriptimi serbisht dhe shkrimin cirilik nuk është i rëndësishëm për shkak se është e rëndësishme që në dokumenta të shkruhen saktë emrat personal në gjuhën e pakicës. Problemi ndodh në rastet individuale, dmth. te ata tek të cilët nuk është bërë korrigjimi i transkriptimit të gabuar të emrit në gjuhën dhe shkrimin shqip. Siç është thënë se, Komisioni zgjedhor republikan dërgon si formular vendimin në të cilin emri personal është shënuar në gjuhën e pakicës kombëtare dhe çdo gjë tjetër plotësohet në gjuhën serbe.

Lidhur me këtë, përfaqësuesit e administratës komunale kanë theksuar se do të ishte e rëndësishme që formularët që i lëshon Komisioni zgjedhor republikan të bëhen edhe në gjuhën shqipe, edhe pse kjo nuk është obligim ligjor.

Ata gjithashtu kanë theksuar se palët ankohen se në vendimin për regjistrimin në listën unike të votuesve, emri personal shënohet në gjuhën dhe shkrimin pakicës kombëtare, kurse të dhënat tjera në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik.

Praktikë e mëhershme ishte që vendimet të përpilohen vetëm latinisht, u arrit progres, nëse marrim parasysh se është urdhëruar që të gjitha të vendimet të përpilohen në dy gjuhë.

Problemi me mungesën e përkthyesve profesional është kanë theksuar gjithashtu edhe në Komunën e Preshevës, ku punon një përkthyes, me sqarimin se për këtë ka mangësi në hartimin e vendimeve në përputhje me ligjin.

Duke pasur parasysh se në komunën e Preshevës është hap reparti i maternitetit, duhet të theksohet se gjatë këtij viti, sipas informatave të dhëna Mbrojtësit të qytetarëve nga të punësuarit në Shtëpinë e Shëndetit në Preshevë, kanë lindur 31 (tridhjetënjë) foshnje, por nuk kishte regjistrime elektronike, por regjistrimet janë bërë sipas Rregullores së vjetër.

Në Preshevë është theksuar në veçanti se është e nevojshme të organizohen trajnime shtesë për punonjësit e shërbimit të ofiqarisë, por edhe për punonjësit shëndetësorë që të plotësojnë aplikacionin

elektronik për regjistrimin e lindjes e fëmijës. Edhe pse deri më tani nuk ka pasur regjistrime elektronike, ofiqari i nga Presheva, i cili ka ndjekur trajnimin për regjistrimin elektronik në Vranjë, ka theksuar se duhet t'i kushtohet vëmendje kësaj çështje.

Sa i përket trajnimit të punonëtorëve të shëndetësisë, dy infermiere kanë kryer trajnimin për regjistrimin elektronik të lindjeve, por është vënë re se nuk janë siguruar kushtet teknike për regjistrim elektronik të lindjeve, p.sh. përkatësisht pajisjet e nevojshme kompjuterike si dhe qasje në internet. Ngjajshëm si te ofiqari, është theksuar rëndësia e trajnimit shtesë dhe të vazhdueshëm për të punësuarit në shëndetësi, pasi që nga trajnimi i fundit kanë kaluar më shumë se 6 muaj. Meqenëse pa dyshim ekziston vetëdija e shprehur se çështjet e emrit personal dhe shenimet tjera që i fut punëtori shëndetësor janë çështje shumë të rëndësishme statusore, është shumë e rëndësishme që të ketë personel të trajnuar i cili mirret me këto çështje.

REGJISTRIMI ELEKTRONIK I LINDJES SË FËMIJËS “BEBUSH, MIRË SE ERDHE NË BOTË”

Projektin “Bebush, mirë se erdhe në botë” e ka filluar Ministria e administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale SI dhe Kabineti i kryeministrit të Serbisë me maternitetet në Serbi. Sistemi i regjistrimit elektronik është instaluar në 50 përqind të materniteteve, dhe është njoftuar se do të mbulohet i tërë territori Serbisë.

Prindërit kanë një mundësi të re për të marrë dokumentacionin e nevojshëm për të porsalindurin. Sistemi i rimundëson për caktimin e emrit personal të fëmijës, regjistrimin e vendbanimit dhe sigurimin shëndetësor si dhe për caktimin e nënshitetësisë në institucionin shëndetësor në të cilin ka lindur fëmija. Procedura është e thjeshtë dhe nuk është e nevojshme të shkohet në ofiqari. E gjithë procedura është papagesë.

Prindërit do të informohen për përfundimin e procedurave. Dokumentacioni (çertifikata e lindjes, vërtetimi i nënshitetësisë si dhe kartela e sigurimit shëndetësor) do t’iu dërgohet në adresën e shtëpisë.

Emri personal i fëmijës (emri dhe mbiemri) caktohet nga prindërit. Nëse nëna nuk dëshiron të tregoj të atin, emrin e cakton vet. Mbiemri caktohet në bazë të mbiemrit të njërit ose të të dy prindërve - kjo do të thotë se fëmija mund të bart mbiemrin e babait ose të nënës apo edhe të dy mbiemrat. Nëse prindërit kanë disa fëmijë të përbashkët, fëmijës i caktohet mbiemri që e kanë caktuar edhe fëmijëve tjerë të përbashkët. Numri i fjalëve që mund të përbëhet emri personal nuk është i kufizuar. Megjithatë, në qoftë se prindërit e fëmijës i caktojnë emrin personal i cili që përbëhet nga më shumë se tri fjalë, janë të detyruar t’i caktojnë edhe emrin e shkurtuar personal.

Vendqëndrimi i fëmijës paraqitet sipas vendbanimit të prindërve. Nëse prindërit jetojnë në të njëjtën adresë, paraqitja bëhet në formë automatike. Nëse ata nuk jetojnë në të njëjtën adresë, prindërit zgjedhin se ku do të regjistrohet fëmija. Fëmija paraqitet për sigurim shëndetësor sipas sigurimit aktiv të njërit prind (sipas zgjedhjes së tyre).

Nëse prindërit janë në kurorë, babai i fëmijës konsiderohet bashkëshorti i nënës. Nëse nuk janë, baba konsiderohet mashkulli atësia e të cilit

është vërtetuar me pranim. Pranimi i atësisë bëhet para ofiqarit, organit të kujdestarisë, noterti ose në gjykatë. Procedura mund të bëhet pa praninë e nënës; është e nevojshme aë ajo të jap pëlqim pas lindjes. Preferohet që babai të pranojë atësinë në ofiqari ku edhe ka vendbanimin, në mënyrë që procedurat tjera të kryhen më shpejt.

E DREJTA PËR ZGJEDHJEN DHE PËRDORIMIN E EMRIT PERSONAL NË GJUHËN SHQIPE DHE SIPAS DREJTSHKRIMIT TË SAJ NË TERRITORIN E VETËQEVERISJEVE LOKALE NË TË CILAT GJUHA SHQIPE NUK ËSHTË NË PËRDORIM ZYRTAR

Qyteti i Vranjës

Duke pasur parasysh se shumica e pjesëtareve të pakicës kombëtare shqiptare që jetojnë në komunat Bujanoc dhe Preshevë vendosin që të lindin në spitalin e Vranjës, gjë që tregon edhe numri i vogël i lindjeve në maternitetin jashtëspitalor të Preshevës, Mbrojtësi i qytetarëve (Ombudsmani) ka biseduar me shërbimet përkatëse të qytetit dhe ka vizituar maternitetin, për të vërtetuar rregullsinë e regjistrimit në evidencat publike të emrit personal në gjuhën shqipe dhe sipas drejtshkrimit të saj.

Në Vranjë bëhet kryhet një numër i madh i lindjeve jo vetëm i qytetarëve nga komunat Bujanoc e Preshevë, por edhe nga komunat e veriut të Kosovës, rreth dy mijë lindje në vit.

Duke kontrolluar drejtpërdrejtë librat amzë u konfirmuan pohimet mbi numrin e madh të regjistrimit të fëmijëve të kombësisë shqiptare. Gjithashtu, është konstatuar se regjistrimet që u kontrolluan kryesisht janë regjistruar sipas drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Megjithate, duhet të theksohet se një numër i caktuar i emrave shqip është bërë në shkrimin latin, për shembull me б (Ć) dhe Ш (Š), edhe pse ato shkronja nuk ekzistojnë në gjuhën shqipe.

Gjatë hulumtimit, ofiqarët gjithashtu theksuan edhe problemin se në program nuk mund të ndryshojnë të dhënat që i futin personeli shëndetësorë në regjistrin elektronik, prandaj për këtë ata kanë vështirësi gjatë përcaktimit të çështjeve statusore. Ata gjithashtu kanë theksuar se nëse regjistrimi themelor është në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, regjistrimi i mëvonshëm mund të bëhet vetëm në bazë të vendimit të organit kompetent. Me këtë konfirmohet pretendimi se

është e nevojshme dhe jashtëzakonisht e rëndësishme që punëtorët shëndetësorë të cilët kryejnë regjistrimin elektronik të lindjes së fëmijëve t'i informojnë prindërit për të drejtën për të shkruar emrin personal të fëmijës në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare.

Si risi dhe devijim nga ato që ishin përcaktuar deri tani, punonjësit e gjendjes civile theksuar faktin se disa palë të kombësisë shqiptare nuk duan të ndryshojnë emrat e tyre nga latinishtja në shqip, (shembull: SH ose Š). Për të përmirësuar realizimin e kësaj të drejte, shërbimi i ofiqarisë në Vranjë ka krijuar praktikë të mirë që vet pala të shkruajë emrin në gjuhën shqipe dhe sipas drejtshkrimit të saj. Megjithatë, duhet theksuar se kjo është një praktikë e mirë e ofiqarëve me të cilët është zhvilluar biseda, çka nuk nuk do të thotë se është e domosdoshme që edhe ofiqarët e tjerë të veprojnë në këtë mënyrë, përkatësisht të kërkojnë që pala të shkruajë emrin dhe mbiemrin e vet. Në këtë kuptim, duhet të mendohet për rëndësinë dhe rregullsinë e dhënies së udhëzimeve për ofiqarët në mënyrë që të harmonizohet praktika e gjatë regjistrimit të emrit personal në gjuhën dhe shkrimin se pakicës kombëtare.

Edhe pse nuk është lëndë i këtij hulumtimi, gjatë zbatimit të tij, Mbrojtësi i qytetarëve ka ardhur deri te njohuritë edhe për një problem tjetër që ndodh në lidhje me regjistrimin elektronik të lindjes së fëmijës. Pra, ndodh që deklarata për njohjen e atësisë të jepet në maternitet nga ana e personelit shëndetësor, çka nuk është e parashikuar me ligj, por që sipas ligjit pranimi i atësisë bëhet te ofiqari. Ky lehtësim për pasojë ka ate që, në një numër rastesh pala pas kësaj të mos vijë në ofiqari, gjë që krijon probleme në punën e shërbimit të ofiqarisë.

Për punët e regjistrimit elektronik të lindjes në Qendrën spitalore në Vranjë është e ngarkuar një punëtoare administrative që ka ndjekur trajnimin njëditor për punën në sistemin e regjistrimit elektronik. Me sistematizim nuk është paraparë ky vend pune, dhe me vendim është caktuar për të punuar në zyrën e shkrestores. Megjithatë, duke pasur parasysh numrin e madh të lindjeve, përkatësisht të paraqitjeve të aritura, problem të madh paraqet ajo që se vetëm një person është caktuar për të kryer regjistrimin. Vështirësi të veçanta ndodhin kur ajo është në pushim vjetor ose mungon për arsye shëndetësore, sepse atëherë nuk ka kush ta zëvendësojë ate, për çka edhe të dhënat futen më vonë.

Punonëtores adminsitrativë i janë dhënë udhëzimet profesionale lidhur me futjen e të të dhënave. Udhëzimi përmban pjesën ku posaçërisht përshkruhet regjistrimi i emrit personal të fëmijës në gjuhën

dhe shkrimin e pakicës kombëtare. Aplikacioni për regjistrimin e të të dhënave në menunë rrëshqitëse ka 10 gjuhë. Për fat të keq, duhet të theksohet se për përpunimin e një regjistrimi elektronik është e nevojshme të klikohet 81 herë në aplikacion. Punëtorja administrative që kryen këto punë, për ndryshim nga ofiqari, ka thkesuar se procedura e regjistrimit ndërpritet nëse nuk janë zgjidhur të gjitha çështjet staturore (nënshtetësia e prindërve, atësia ...), dhe se nuk marrin deklaratat e atësisë sepse nuk janë kompetentë.

Punëtorja administrative në detaje ka përshkruar praktikën e regjistrimit të emrit personal të fëmijës. Emri personal i fëmijës, kur regjistrohet në gjuhën dhe shkrimin shqip, regjistrohet kryesisht sipas të dëgjuarit, ashtu siç e shqiptojnë prindërit, por pastaj kërkohet nga prindërit që të kontrollojnë se a është regjistrimi i saktë para se të përfundohet regjistrimi në program. Më parë, ka kërkuar nga prindërit që të shkruajnë në letër se si shkruhet emri personal, por tani atë e bënë rallë, sepse mendon se mjaft mirë i njeh emrat personal në gjuhën shqipe dhe se mund t'i shkruajë sipas rregullave të drejtshkrimit shqip.

Si problematike, duke biseduar me atë, u sqarua fakti se ajo nuk ka të drejtë për qasje në çertifikatën e martesës, dhe se këto të dhëna i regjistron sipas asaj që tregojnë palët, ndërsa në anën tjetër kur ofiqarit, i arrin regjistrimi elektronik nuk ka mundësi që të ndryshoj të dhënat në aplikacion.

Për punën e ligjshme dhe të rregullt të personave që kryejnë punët e regjistrimit elektronik, është përgjegjës grupi i punës i përbërë nga Ministria e administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale, Ministria e shëndetësisë, Drejtoria për administratën elektronike si dhe nga organe të tjera kompetente. Kur ekziston ndonjë problem me regjistrimin elektronik, është caktuar kontakti i drejtpërdrejtë me personat e autorizuar të cilët njoftohen me problemin.

Qyteti i Leskovcit

Për dallim nga Vranja, Leskovci, ku numri i përgjithshëm i lindjeve është 1172, në bazë të të deklarimeve të shërbimit përkatës të ofiqarisë është një numër shumë i vogël lindjeve të fëmijëve të kombësisë shqiptare. Kështu, në vitin 2017, nuk kishte asnjë regjistrim të emrit të fëmijës së porsalindur në gjuhën shqipe, kurse në vitin 2016 -të ka qenë dy regjistrime, prej të cilëve njëri ka qënë regjistrim elektronik.

Regjistrimi elektronik i të porsalindurve në Leskocv ka filluar më 22 qershor 2016-të. Sipas shikimit të formularëve të regjistrimit të cilët Mbrojtësi i qytetarëve ka kontrolluar në Leskocv, emrat e fëmijëve janë regjistruar vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, sepse as prindërit nuk kanë regjistrim paralel por vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik. Edhe pse ofiqarët thojnë se gjithmonë i informojnë palët për të drejtën e tyre për regjistrimin e emrit të tyre edhe në gjuhën e pakicës, në praktikë ende është e dukshme se palët nuk e dinë se kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për regjistrim të mëvonshëm në gjuhën dhe shkrimin e tyre.

Në vitet e mëhershme, praktika e shërbimit të ofiqarisë ishte që regjistrimi i pjesëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare, d.m.th. që regjistrimi paralel mund të bëhet në alfabetin latin e jo sipas gjuhës shqipe dhe drejtshkrimit shqip. Duhet të theksohet se kjo nuk ishte një praktikë ligjore dhe se regjistrimi në shkrimin latin nuk është regjistrim në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, në këtë rast në gjuhën shqipe.

Aktualisht, pesë ofiqarë kanë çertifikata për të punuar në Regjistrin qendror, ndërsa tre punëtorë shëndetësorë kanë çertifikata për regjistrim elektronik - përveç dy zyrtareve edhe një infermiere e gjinekologji-obs-trietrikës ka çertifikatë për të kryer regjistrimin elektronik.

Edhe në Leskocv, vepohet në të njëjtën mënyrë si në Vranjë, kur bëhet fjalë për çështjet e pazgjidhura statusore. Me fjalë të tjera, regjistrimi elektronik ndërpehet. Siç kanë theksuar edhe ofiqarët, edhe punëtorët shëndetësor në komunat tjera, ku Mbrojtësi i qytetarëve ka kryer hulumtime, ashtu edhe në Leskocv kanë theksuar se trajnimi nuk ishte i mjaftueshëm që punëtorët shëndetësor të njihen me të gjitha situatat që mund të paraqiten në praktikë gjatë regjistrimit. Trajnimi për ofiqarët është organizuar dy herë, por kryesisht vet kanë ushtruar në aplikacion. Me qëllim të punës efikase dhe kapërcimit të problemeve, punëtorët shëndetësor tani kontaktojnë me telefon ofiqarët, me të cilët kanë bashkëpunim të shkëlqyer, për konsultime.

Personave që kryejnë punët e regjistrimit elektronik të lindjes së fëmijës, punëtorëve shëndetësor dhe ofiqarëve iu është siguruar administratori në Ministrinë e shëndetësisë të cilin e kontaktojnë gjatë punës në aplikacion, nëse kanë nevojë për ndihmë.

Në Spitalin e përgjithshëm në Leskocv, në punët e regjistrimit elektronik të lindjes së fëmijës punojnë dy punonëtores, dhe kështu tejkalohen problemet që janë konstatuar në punën e punotores

administrative në Vranjë. Në mënyrë të ngjashme si kolegja e saj në Vranjë, edhe ato në rastet e regjistrimit të emrit personal në gjuhën shqipe dhe sipas drejtshkrimit, iu japin prindërve letër që ta shkruajnë vetë emrin personal të fëmijës dhe më paskështu atë emër e regjistrojnë në formular elektronik. Kur u pyetën për të sqaruar praktikën në kuptim të obligimit të informimit të qytetarëve, kanë theksuar të dhënë se gjithmonë i njoftojnë palët se kanë të drejtë që emrin personal ta regjistrojnë në gjuhën e pakicës kombëtare.

Qyteti i Nishit

Regjistrim elektronik i lindjes së fëmijëve në Nish ka filluar më 3 nëntor 2016-të. Rreth 2.800 bebe linden çdo vit në Nish. Përkundër kësaj të dhëne, vetëm një person është caktuar për regjistrim elektronik.

Duke shikuar kopjet e certifikatave të librave amzë të të lindurve, të cilat i ka parë Mbrojtësi i qytetarëve gjatë vizitës në shërbimin e ofiqarisë, është konstatuar se regjistrime të caktuara të emrave personal në gjuhën dhe shkrimin shqip ishin regjistruar gabimisht. Kështu që, disa regjistrime janë kryer ashtu që emri është shkruar në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, dhe se vetëm mbiemri ishte regjistruar në gjuhën shqipe. Mbrojtësit të qytetarëve i është dhënë shpjegimi se kjo ka ndodhur sepse kështu është shkruajtur mbiemri njësoj në shkrimin cirilik dhe latin. Për më tepër, Mbrojtësi i qytetarëve ishte vërtetuar se regjistrimi i tillë është bërë edhe në regjistrin qendror.

Gjithashtu, edhe pse prindërit e kanë paraqitur emrin e fëmijës në gjuhën dhe shkrimin shqip, ofiqarët nuk mund të ndryshojnë këtë të dhënë, kompetentët kanë shprehur mendimin se emri personal i fëmijës mund të regjistrohet në gjuhën dhe shkrimin shqip vetëm nëse në librat amzë është bërë edhe për prindërit një regjistrim i tillë. Fatkeqësisht, duhet të theksohet se ky veprim është i gabuar, pasi që zgjedhja dhe përdorimi i emrit personal të fëmijës është i lirë dhe nuk lidhet me atë se si janë shkruajtur emrat e prindërve të fëmijës, emri i të cilit regjistrohet.

Duke pasur parasysh regjistrimin e tillë të paregullt, përgjegjësve në shërbimin e ofiqarisë iu është thënë se është nevojshme të korrigjohen regjistrimet. Pra, përveç korrigjimit të mundshëm si gabim teknik, është rënë dakord që të bëhen korrigjime edhe në librin amzë, sepse në bazë të certifikatës në të cilën nuk ka regjistrim paralel të emrit personal edhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, Ministria

e punëve të brendshme nuk mund të lëshojë letërnjoftimin sipas emrit personal në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare.

Megjithëse në shërbimin e ofiqarisë janë të punësuar dhjetë punonëtor, vetëm dy ofiqar kanë çertifikata për të punuar në regjistrin qendror. Përveç kësaj, shërbimi i ofiqarisë ka njoftuar se kushtet teknike janë shumë të dobëta.

Brengosës është interpretimi në shërbimin e ofiqarisë në Nish, se sipas tingullit, nga rasti në rast, caktohet se si a shkruhet emri njësoj në gjuhën shqipe si dhe në shkrimin latin, për çka edhe vjen deri te regjistrimet e parregullta. Duhet theksuar, se në bazë të çertifikatave të tilla si i bënë shërbimi i ofiqarisë, nuk mund të lëshohet letërnjoftimi, përkatësisht që emri personal të regjistrohët në letërnjoftim në shkrimin e pakicës kombëtare. Kjo sjell në një situatë të pafavorshme për palën e cila duhet të paraqesë kërkesën për korrigjim, në mënyrë që më vonë të mund të ushtrojë të drejtën që emri personal në letërnjoftim ti shkruhet në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare.

Gjithashtu, nga një këndvështrim krejtësisht tjetër, brengosje shkakton edhe njohuria, më saktësisht deklarata e përfaqësuesve të shërbimit të ofiqarisë se nuk kanë marrë njoftim nga Ministria e administratës shtetërore dhe të vetëqeverisjes lokale lidhur me regjistrimin e mëvonshëm të emrit personal në gjuhën e pakicës kombëtare dhe sipas drejtshkrimit të asaj gjuhe.

Çertifikatat që i kanë bërë gabimisht, kanë se teknikisht do t'i korrigjojnë. Në libra regjistrimet janë të sakta, prandaj çertifikatat do të korrigjohen sipas origjinalit.

Sa i përket regjistrimit elektronik në Qendrën klinike të Nisht, zyrtari që e bënë regjistrimin elektronik të lindjes ka deklarues se deri tani ka pasur vetëm një regjistrim të fëmijës të kombësisë shqiptare.

Regjistrimin e bënë në bazë të asaj çka shkruajnë prindërit në letër. Kur janë në fjalë shkronjat që nuk i ka gjuha serbe, e që ka gjuha shqipe, zyrtari nuk është në dijeni se në menunë rrëshqitëse aplikacioni për regjistrim ka dhjetë gjuhë. Ai nuk bën dallimin midis të drejtës së shtetasve të huaj dhe të drejtave të pakicave kombëtare.

Kjo është pasojë e asaj që zyrtari nuk është trajnuar, por është i njoftuar me atë se ekzistojnë udhëzimet lidhur me plotësimin e formularit elektronik të regjistrimit. Nuk është informuar për regjistrimin në gjuhën e pakicës kombëtare.

Brenda ditës përpunohen nga 12 deri në 18 regjistrime, dhe sipas delarimeve të zyrtarit që kryen punën e regjistrimit nuk arrijnë që t'i regjistrojnë, për atë edhe përdorin formularët dhe mënyrat e vjetra të regjistrimit të fëmijës së porsalindur.

Planifikohet që të bëhet çertifikimi edhe i një zyrtares, por as ajo ende nuk e ka kryer trajnimin. Kushtet teknike nuk janë të kënaqshme.

KONKLUZIONE

Mungesa e kuadrove dhe e mjeteve financiare në vetëqeverisjet lokale janë një arsye e rëndësishme se pse përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit shqip nuk zbatohet plotësisht në mënyrën se si është e garantuar me ligj, gjë që është e dhënë për të cilën Mbrojtësi i qytetarëve ka bërë vërejtje vite më parë.

Përveç kësaj, mungesa, përkatësisht fakti që informatat e nevojshme nuk iu janë në dispozicion qytetarëve, janë pengesë për një realizimin e plotë dhe efikas të së drejtës për regjistrimin e emrit personal në letërnjoftim, në dokumentet e tjera zyrtare si dhe në evidencat zyrtare në gjuhën shqipe dhe sipas drejtshkrimit të saj.

Organet republikane nuk kanë vetëdijen e mjaftueshme për rëndësinë dhe përgjegjësinë ndaj obligimeve të tyre që tabelat e emërtimeve të organeve të shkruhen në të gjitha gjuhët që janë në përdorimin zyrtar, në rastin konkret në komunat e lartpërmendura, në gjuhën dhe shkrimin shqip.

Edhe pse nuk ka ankesa konkrete të qytetarëve që nuk e kanë realizuar të drejtën në regjistrimin elektronik të lindjes së foshnjës që të regjistrojnë të dhënat e emrit personal të fëmijës në gjuhën shqipe dhe sipas drejtshkrimit të asaj gjuhe, në praktikë janë vërejtur mangësi të caktuara.

Statusi i papërshtatshëm në punë, si dhe trajnimi i pamjaftueshëm i punëtorëve shëndetësor që kryejnë atë punë, mund të jenë në dëm të të drejtave të qytetarëve. Është e nevojshme që të precizohet domosdoshmëria se në regjistrimin elektronik të lindjes së foshnjave mund të punojë vetëm personi i cili më parë ka përfunduar të gjitha trajnimet, për të parandaluar atë që persona të pakualifikuar ose persona pa ndonjë trajnim paraprak të kryejnë një punë të tillë kaq të rëndësishme dhe të jenë përgjegjës për saktësinë e të dhënave të regjistruara, siç është përkatësia pakicës kombëtare apo emri personal në gjuhën dhe shkrimin e pakicës të cilës i takon fëmija.

Është praktikë e mirë, që në mungesë të katalogëve të emrave personal të shkruara sipas gjuhës dhe drejtshkrimit asaj gjuhe si doku-

ment zyrtar, që për shkak të rregullsisë së regjistrimit të emrit personal të fëmijës, të kërkohet nga prindërit që para regjistrimit të të dhënave në regjistrimin elektronik të shkruajnë vetë emrin e fëmijës së porsalindur në gjuhën dhe shkrimin e pakicës që i përkasin, me qëllim që të mos ndodh që në rastin e pakicës shqiptare regjistrimi të bëhet në alfabetin latin, por jo në bazë të drejtshkrimit të gjuhës ose sipas tingullit. Gjithashtu, Mbrojtësi i qytetarëve konsideron si mjaft të dobishme praktikën, e cila duhet të vazhdohet dhe të zgjerohet, që nga prindërit të kërkohet që para përfundimit të regjistrimit të kontrollojnë dhe miratojnë regjistrimin e emrit personal sipas asaj që e kanë shkruajtur vetë. Për qëllim të besueshmërisë, në qoftë se e mundësojnë kapacitetet, duhet të mendohet edhe për nevojën e dokumentimit të të dhënave të marra në këtë mënyrë.

Nga ana tjetër, realiteti është se ekziston mundësia që prindërit të mos kenë këtë mundësi, prandaj krijimi i katalogëve të emrave më të shpeshtë personal që janë shkruar në mënyrë të rregullt në gjuhën shqipe dhe sipas drejtshkrimit, me shqiptim fonetik, sipas mendimit të Mbrojtësit të qytetarëve është mënyra më e mirë dhe e drejtë për zgjidhjen e problemeve të vërejtura deri më tani. Për më tepër, kjo zgjidhje mund të zbatohet edhe në rastin e gjuhëve të tjera të pakicave rregullat drejtshkrimore të të cilave janë të ndryshme nga gjuha serbe.

REKOMANDIMET

Me qëllim të eliminimit të të gjitha problemeve dhe parregullsive të identifikuara, si dhe avansimit të ushtrimit të së drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip, përkatësisht të zgjedhjes dhe përdorimit të emrit personal në gjuhën dhe shkrimin shqip, Mbrojtësi i qytetarëve i paraqet këto rekomandime Ministrisë së administratës shtetërore dhe të vetëqeverisjes lokale dhe Ministrisë së shëndetësisë:

- është e nevojshme që Ministria e administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale t'iu dërgojë përsëri njoftimin të gjitha shërbimeve të ofiqarisë lidhur me regjistrimin e mëvonshëm të emrit personal në gjuhën e pakicës kombëtare dhe sipas drejtshkrimit të asaj gjuhe;
- është e domosdoshme që Ministria e administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale, në bashkëpunim me Këshillin kombëtar të pakicës kombëtare shqiptare, të shqyrtojnë nevojën dhe mënyrën e krijimit të një katalogu të emrave dhe mbiemrave në gjuhën dhe shkrimin shqip që do të ndihmonte, edhe si instrument i vlefshëm për ofiqarët në punën e tyre gjatë regjistrimit;
- është e nevojshme që Ministria e administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale dhe Ministria e shëndetësisë të organizojnë trajnime shtesë për ofiqarët si dhe punëtorët në qendrat shëndetësore që kryejnë regjistrimin elektronik të lindjes së fëmijës në lidhje me regjistrimin e emrit personal në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare;
- është e nevojshme që vetëqeverisjet lokale dhe Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare, në pajtim me kompetencat e tyre, të ndërmarrin të gjitha masat dhe aktivitetet e nevojshme për informimin e plotë, të saktë dhe në kohë të qytetarëve për të drejtën e regjistrimit të emrit personal në gjuhën dhe sipas drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Mbrojtësi i qytetarëve konsideron se është e nevojshme, sa më parë që të jetë e mundur, që organet të shqyrtojnë edhe çështjet e tjera të mbetura që janë paraqitur në këtë raport, dhe të vendosin nëse zgjidhja e tyre mund të sigurohet vetëm përmes ndryshimeve dhe plotësimeve të dispozitave ekzistuese ose që avansimi i situatës është i mundur edhe me organizimin e seminareve dhe trajnimeve për përfaqësuesit e vetëqeverisjeve lokale dhe të qendrave shëndetësore, me qëllim të harmonizimit të praktikës në punë, të eliminimit të parregullsive dhe të realizimit sa më efikas të të drejtave të pjesëtarëve të pakicave kombëtare.

Shtesa 1

Pasqyra e rasteve dhe rekomandimeve të Mbrojtësit të qytetarëve për periudhën 2011 - 2016 - të, lidhur me ushtrimin e të drejtës për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare, përkatësisht të të drejtës për të zgjedhur dhe përdorur emrin personal në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare shqiptare

E drejta për të zgjedhur dhe përdorur emrin personal

Ankesa e bërë për punën e Stacionit policor të Bujanocit, sepse emri personal është regjistruar në vërtetimin e paraqitjes së vendbanimit në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik. Në të vërtetë, aplikacioni i softuerit nuk e mbështet regjistrimin emrit personal në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, regjistrimi është i mundur vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, përkatësisht në alfabetin latin.

Pas procedurës së kryer, Ministria e punëve të brendshme ka filluar procedurën e riprogramimit të aplikacionit, me qëllim që të mundësojë ushtrimin e të drejtës së pjesëtarëve të pakicave kombëtare për të zgjedhur dhe përdorur emrin personal në përputhje me gjuhën dhe drejtshkrimin e pakicës kombëtare. Problemi i regjistrimit për rastin konkret, është zgjidhur me regjistrimin manual të emrit personal në SP në Bujanoc.

Gjatë kësaj procedure, është arritur deri te njohuritë se regjistrimi i emrit personal nuk ishte bërë siç duhet as në librin amzë të të lindurve, përkatësisht emri personal ishte regjistruar në alfabetin latin edhe paralelisht, në kllapa, në gjuhën shqipe, por jo edhe mbiemri. Duke pasur parasysh që Ligji mbi librat amzë parashikon që emri personal duhet të shkruhet në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik edhe paralelisht në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, Mbrojtësi i qytetarëve ka njoftuar Ministrinë kompetente të administratës shtetërore me qëllim të mbikëqyrjes së punës ndaj shërbimeve të ofiqarisë.

Meqenëse e drejta e përdorimi të emrit personal dhe regjistrimi i tij në dokumentet personale në evidenca të tjera bëhet sipas origjinalit ose ekstraktit nga libri amzë, regjistrimi i tillë i parregullt mund të ketë pasoja për çdo regjistrim të mëvonshme të emrit në evidenca të ndryshme. Në rastin konkret, mbiemri do të shkruhej në shkrimin latin sipas origjinalit e jo në gjuhën shqipe.

E drejta për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare shqiptare

Ankesën e ka paraqitur Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare ndaj punës së Administratës tatimore, Filiala Bujanoc, sepse është refuzuar kërkesa në gjuhën shqipe drejtuar Filialës, edhe pse në territorin e komunës së Bujanocit gjuha shqipe është në përdorimin e barabartë zyrtar. Si arsye për refuzimin e pranimit të kërkesës, organi është deklaruar se punonëtorët nuk ishin të informuar se ata kanë obligim për të vepruar në rastin e aplikimit vetëm në gjuhën dhe shkrimin shqip. Megjithatë, Mbrojtësi i qytetarëve që në vitin 2013, duke vepruar në bazë të ankesës së Këshillit kombëtar të pakicës kombëtare hungareze, i ka dërguar një mendim Ministrisë së financave që është e nevojshme për të informuar të gjitha qendrat rajonale dhe njësitë rajonale të Administratës tatimore për obligimin e sigurimit të realizimit të të drejtave të qytetarëve për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare në procedurat para Administratës tatimore. Po ashtu, që pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë të plotësojnë formularët e regjistrimit të taksave në gjuhën dhe shkrimin e tyre, megjithëse ato janë të shtypura në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik.

Rekomandimi për FRSSH –në e drejta për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare shqiptare

Ankesën e ka paraqitur Këshilli Kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare për punën e Fondit të republikan të sigurimit shëndetësor, duke njoftuar se kartelat biometrike të shëndetësë bëhen vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, si dhe ate se Zyra e Bujanocit refuzon t'i përgjigjet kërkesës së bërë në gjuhën dhe shkrimin shqip, duke kërkuar që të dorëzohet përkthimi në gjuhën serbe nëse presin përgjigje. Gjatë procedurës së kontrollit, Mbrojtësi i qytetarëve ka konstatuar se Zyra

e Bujanocit ka vepruar në mënyrë të parregullt dhe të paligjshme kur ka refuzuar t'i përgjigjet kërkesës së drejtuar në gjuhën shqipe si dhe FRSSH, Filiala në Vranjë, sepse nuk ka theksuar njoftimin për të drejtën e pjesëtarëve të pakicave kombëtare që dokumentin për sigurimin e kujdesit shëndetësor mund të marrin edhe në gjuhën shqipe dhe shkrimin që është në përdorim zyrtar në territorin e komunës së Bujanocit.

Është drejtuar rekomandimi FRSSH Vranjë se është e nevojshme të sigurohet realizimi i të drejtave të qytetarëve që në komunikimin verbal si dhe me shkrim, si dhe procedurat për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe detyrimeve, të përdorin gjuhën dhe shkrimin shqip. Është rekomanduar gjithashtu që të vendoset njoftimi për mënyrën e ushtrimit të të drejtave të pjesëtarëve të pakicave kombëtare për të marrë dokumentin e sigurimit shëndetësor në gjuhën dhe shkrimin shqip.

FRSSH ka vepruar sipas rekomandimeve të Mbrojtësit të qytetarëve. Është organizuar puna e Zyrës në Bujanoc që personave që i përkasin pakicave kombëtare mund të ushtrojnë të drejtën e përdorimit të gjuhës dhe shkrimit shqip, në komunikim dhe procedura, kështu që 2 të punësuar përdorin gjuhën dhe shkrimin shqip dhe të përdorin kartelat të shëndetit në gjuhën dhe shkrimin shqip. Poashtu është vendosur njoftimi në vend të dukshëm për mënyrën e ushtrimit të së drejtës për të marrë dokumentin e sigurimit shëndetësor në gjuhën dhe shkrimin shqip. Njoftimi është vendosur në gjuhën serbe dhe shqipe.

Rekomandimi FRSSH-së / të sigurohet ushtrimi i të drejtës për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit në njësitë organizative në territoret ku gjuha dhe shkrimi i pakicës kombëtare është në përdorim të barabartë

Ankesën e ka paraqitur Këshilli Kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare për punën e FRSSH, Zyra e Bujanocit, duke njoftuar për shkeljen e së drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip. Duke pasur parasysh, se përsëri është njoftuar për shkeljen e të drejtës për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare, mbrojtësi i qytetarëve i ka dërguar rekomandim Drejtorisë – së FRSSH, se gjatë ndryshimeve dhe plotësimeve, ose sjelljes së Rregullores së re mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, të kenë parasysh përbërjen kombëtare të popullsisë dhe përfaqësimit adekuat të pjesëtarëve të pakicave kombëtare në njësitë organizative.

Gjithashtu, se është e nevojshme që Drejtoria të mbledhë të dhëna, përkatësisht të mbajë evidencë për ate se sa të punësuar e njohin gjuhën e pakicës kombëtare për të gjitha njësitë organizative selia e të cilave është në territorin e vetëqeverisjes lokale në të cilën është vendosur në përdorim të barabartë zyrtar gjuha dhe shkrimi i pakicës kombëtare. Për të ushtruar të drejtën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, është rekomanduar që Drejtoria të sjellë udhëzime mënyrën e punës së njësive organizative, si dhe të siguroj vendosjen e njoftimeve për të drejtën për të marrë dokumentin e sigurimit shëndetësor në gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare në territoret ku është në përdorim të barabartë zyrtar gjuha dhe shkrimi i pakicës kombëtare.

Mendimi me rekomandim për Ministrinë së administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale për unifikimin e praktikës së shërbimeve të ofiqarisë gjatë regjistrimit të mëvonshëm të emrit personal sipas gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare

Mbrojtësi i qytetarëve i ka dërguar Mendimin me rekomandim Ministrisë së administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale, duke pasur parasysh ate se është vërejtur se ka paqartësi dhe procedim jo të njejtë në shërbimeve të ofiqarisë gjatë regjistrimit të emrit personal sipas gjuhës dhe drejtshkrimit të pakicës kombëtare. Mendimi i është dërguar për të siguruar punën e unifikuar të shërbimeve të ofiqarisë në Republikën e Serbisë dhe i referohet asaj se është e nevojshme për të sqaruar në mënyrë plotësuese procedurën për mënyrën e vendosjes mbi kërkesën për regjistrimin e emrit në gjuhën dhe drejtshkrimin e pakicës kombëtare, kur kërkesa është paraqitur pas përfundimit të shënimit themelor në librin amzë, dhe me atë rast parashtruesi i kërkesës nuk posedon dëshmi apo ndonjë dokument zyrtar nga i cili mund të vërtetohet forma e emrit dhe mbiemrit në gjuhën e pakicës kombëtare.

Mbrojtësi i qytetarëve gjatë procedurës së bërë në bazë të ankesës së një pjesëtare të pakicës kombëtare hungareze dhe procedurave të tjera, ka ardhur në përfundim se shërbimet e ofiqarisë në raste të tilla nuk e zbatojnë nenin 26. të Ligjit mbi librat amzë në përputhje me Udhëzimin mbi udhëheqje e librave amzë dhe formularët e librave amzë, dhe sipas detyrës zyrtare nuk kërkojnë mendim nga ana e përkthyesve të autorizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative që ka të bëjë me përkthyesit.

Lidhur me këtë, Ministrisë së administratës shtetëror dhe vetëqeverisjes lokale i është rekomanduar që të informojë shërbimet e ofiqarisë për zbatimin e Udhëzimeve ekzistuese për udhëheqjen e librave amzë dhe të formularëve të librave amzë dhe t'i udhëzojë ata për obligimin zyrtar që të kërkojnë mendimin e përkthyesve të autorizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi administratën e përgjithshme lidhur me përkthyesit në rastet kur një qytetari i pakicës kombëtare, pas përfundimit të regjistrimit themelor në librin amzë, paraqet kërkesë për regjistrimin e emrit personal në gjuhën dhe drejtshkrimin e pakicës kombëtare.

Ministria iu ka dërguar njoftimin e lartpërmendur të gjithë shërbimeve të ofiqarisë për zbatimin në procedurën e vendimmarrjes sipas kërkesës së pjesëtarit të pakicës kombëtare për të regjistrimin e emrit personal si dhe sipas gjuhës dhe shkrimit të pjesëtarit të pakicës kombëtare, pas përfundimit të regjistrimit themelor.

Mendimi me rekomandim Ministrisë së administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale lidhur me obligimin e zbatimit të obligativ të përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare në territorin e njësisë së vetëqeverisjes lokale

Mbrojtësi i qytetarëve që në vitin 2011-të, me Mendim dhe rekomandim e ka njohur Ministrinë kompetente lidhur me mangësitë e identifikuara në Ligjin për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit që e pengojnë realizimin e të drejtave të pakicave kombëtare në përdorimin e barabartë zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të tyre.

Kështu është bërë me dije se, në bazë të ligjit nuk është siguruar që në njësinë e vetëqeverisjes lokale, në përdorim të barabartë zyrtar, të zbatohet medoemos gjuha dhe shkrimi i pakicave kombëtare në rast kur është plotësuar kushti i parashikuar me ligj që në territorin e saj banojnë më shumë se 15% të pjesëtarëve të të njëjtës pakicë kombëtare.

Në kundërshtim me nenin 11, paragrafi 4 dhe neni 19. i Ligjit i cili konsiston në faktin se ata kanë të njëjtin subjekt të rregullimit – Shënimin e emërimit të organit, emërtimet e njësive të vetëqeverisjes lokale, emërtimet e vendbanimeve, shesheve dhe të rrugëve si dhe të toponimeve të tjera në territoret në të cilat ku në përdorim zyrtar janë gjuhët e pakicave kombëtare, e që në mënyra të ndryshme përshkruajnë realiyimin e këtyre detyrimeve, krijohet konfuzion dhe vështirëson

realizimin efikas dhe të plotë të së drejtës për përdorim të barabartë zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare.

Gjiashtu, është u theksuar se me dispozitat e nenit 21. dhe 22. të Ligjit nuk është siguruar mbikëqyrje efektive e zbatimit të Ligjit, e as mjetet financiare të nevojshme për zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtës për përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve të pakicave kombëtare.

Rekomandimi për Ministrinë e punëve të brendshme lidhur me sigurimin e njoftimeve të nevojshme në të gjitha stacionet policore mbi të drejtën e regjistrimit në letërnjoftim të mbiemrave dhe të emrave të pjesëtarëve të pakicave kombëtare në gjuhën e pakicës kombëtare dhe shkrimin e saj

Pjesëaqësuesit e Këshillave kombëtar të pakicave kombëtare i kanë vënë në dijeni Mbrojtësi të qytetarëve se me cilat probleme ballafaqohen pjesëtarët e pakicave kombëtare nëse duan të shkruajnë emrin personal në letërnjoftim në gjuhën dhe alfabetin e pakicës kombëtare. Lidhur me këtë, Mbrojtësi i qytetarëve si Ombudsmani krahinor i kanë rekomanduar Ministrisë së punëve të brendshme që është e nevojshme që të vendoste njoftimi në administratë / stacionet policore për të drejtën e pjesëtarëve të pakicave kombëtare për të regjistruar të dhënat e tyre në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare.

Është e rëndësishme të theksohet se Ministria e punëve të brendshme e ka informuar Mbrojtësin e qytetarëve se ekzistojnë kushte teknike dhe të tjera për regjistrimin e të të dhënave në 10 gjuhë edhe ato: shqipe, boshnjake, bullgare, hungareze, sllovaqe, rumune, ruse, kroate, çeke dhe turke.

Mbrojtësi i qytetarëve, duke vepruar sipas pjesëtarëve të përkatësisë etnike shqiptare nga Medvegja, atëherë ka konstatuar se se shkaku kryesor i realizimit të së drejtës për të regjistruar emrin personal në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare në letërnjoftim, ishte mungesa e informimit të qytetarëve.

Shtesa 2

KORNIZA LIGJORE

Përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit

Korniza nacionale ligjore

Kushtetuta e Republikës së Serbisë në parime e saj, ndër të tjera, përcakton përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit në Republikën e Serbisë. Sipas nenit 10. paragrafi 1. të Kushtetutës, në Serbi në përdorim zyrtar është gjuha serbe dhe shkrimi cirilik. Përdorimi zyrtar i gjuhëve dhe shkrimeve të tjera lejohet me kusht që të bazohet në Kushtetutë dhe të jetë e rregulluar me ligj (neni 10. paragrafi 2. i Kushtetutës).

Neni 79. i Kushtetutës, paragrafi 1. në mënyrë eksplicite përmend sferat e caktuara të jetës shoqërore, në të cilat është e mundur që të përdoren zyrtarisht gjuhët e pakicave: në territoret ku përbëjnë popullsinë e konsiderueshme, pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë që: organet publike (shtetërore, krahinore dhe lokale), si dhe organizatat të cilave iu janë besuar autorizime publike, të zhvillojnë procedurat edhe në gjuhën e tyre; në gjuhën e tyre mund të përdorin emrin dhe mbiemrin e tyre; në territoret ku përbëjnë popullatë të konsiderueshme, emërtimet tradicionale lokale, emërtimet e rrugëve, lagjeve apo shenjat topografike mund të shkruhen edhe në gjuhën e tyre.

Në bazë të nenit 75. paragrafi 2, pjesëtarët e pakicave kombëtare, drejtpërsëdrejti ose përmes vetëqeverisjeve lokale, përkatësisht të këshillave kombëtare të pakicave kombëtare (neni 75. paragrafi 3. i Kushtetutës) marrin pjesë në vendimmarrje ose vetë vendosin për çështje të caktuara lidhur me përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit.

Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit - Në kuptim të Ligjit përdorimi zyrtar nënkupton në veçanti: njoftimin me gojë dhe me shkrim të organeve dhe organizatave ndërmjet tyre, si dhe me palët;

zhvillimin e procedurave për ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të obligimeve të qytetarëve; udhëheqjen e evidencave ligjore; lëshimin e dokumenteve publike si dhe të tjera që janë me interes për realizimin e të drejtave të caktuara të qytetarëve; ushtrimin e të drejtave, të obligimeve si dhe përgjegjësisë të punëtorëve nga marrëdhënia në punë dhe në bazë marrëdhënies së punës. Përdorimi i gjuhës dhe shkrimit gjatë shkrimit të emërtimeve topografike, emërtimeve të organeve, organizatave dhe ndërmarrjeve, si dhe gjatë botimit të ftesave zyrtare, njoftimeve dhe paralajmërimeve dhe të mbishkrimeve publike, konsiderohet gjithashtu si përdorim zyrtar i gjuhës dhe alfabetit (neni 3.).

Neni 6. i Ligjit parashikon të drejtën e çdo personi të përdorë gjuhën e tij / saj në procedurë para organit ose organizatës, që duke ushtruar autorizime publike, vendos për të drejtat dhe detyrimet e tij, të përdor gjuhën e vet dhe për procedurën të njoftohet në gjuhën e vet.

Ligji për përdorimin zyrtar të gjuhës në nenin 11. paragrafi 1. dhe 2. përcakton se në territorin e njësisë së qeverisjes lokale ku tradicionalisht jetojnë pjesëtarët e pakicave kombëtare, gjuha dhe shkrimi i tyre mund të jetë në përdorim të barabartë zyrtar, dhe se njësitë e qeverisjes lokale në statutet e tyre do të vendosin përdorimin e barabartë zyrtar gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare në qoftë se përqindja e kësaj pakice kombëtare në popullsinë e përgjithshme në territorin e saj arrin 15% në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë. Derisa paragrafi 3. i këtij neni përcakton se përdorimi zyrtar i gjuhëve të pakicave kombëtare nga paragrafi 1. i këtij neni nënkupton, ndër të tjera, edhe lëshimin e dokumenteve zyrtare dhe mbajtjen e evidencave zyrtare dhe regjistrave të të dhënave personale në gjuhët e pakicave kombëtare dhe pranimin e këtyre dokumenteve në ato gjuhë, si të vlefshme.

Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare në nenin 11. paragrafi 4. në mënyrë eksplicite parasheh që përdorimi zyrtar i gjuhëve dhe shkrimeve të pakicave kombëtare nënkupton edhe lëshimin e dokumenteve zyrtare dhe mbajtjen e evidencave zyrtare si dhe regjistrimin e të dhënave personale në gjuhët e pakicave kombëtare, si dhe pranimin e këtyre dokumenteve në ato gjuhë si të vlefshme.

Ligji e regullon edhe çështjen e shkrimit të shenjave topografike në gjuhët e pakicave kombëtare, duke futur një risi mjaft të rëndësishme që lejon që këto shenja mund të shkruhen sipas traditës dhe drejtshkrimit të pakicës kombëtare (neni 11. paragrafi 5.). Ligji përmban edhe

dispozitat me të cilat përdorimi zyrtar i gjuhëve të pakicave kombëtare zgjerohet jashtë kufijve të territoreve të vetëqeverisjeve lokale.

Sipas nenit 11. paragrafi 6., ligjet dhe dispozitat tjera, në pajtim me ligjin, shpallen edhe në gjuhët e pakicave kombëtare, përkatësisht është e parashikuar mundësia që pjesëtarët pakicave kombëtare, numri i përgjithshëm i të cilëve në popullatën Republikës së Serbisë arrin të paktën 2% sipas regjistrimit të fundit, mund t'i drejtohen organeve republikane në gjuhën e tyre dhe kanë të drejtë të marrin përgjigje në atë gjuhë (neni 11. paragrafi 7.).

Ligji mbi këshillat nacionale të pakicave kombëtare rregullon kompetencat këshillave kombëtare sa i përket përdorimit zyrtar të gjuhëve të pakicave në nenin 22. Është parashikuar që Këshilli kombëtar të kontribuoj në realizimin e përdorimit zyrtar të gjuhëve të pakicave kombëtare në një mënyrë të tillë që: a) të propozojë vërtetimin e gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare si gjuhë dhe shkrim zyrtar në njësinë e vetëqeverisjes lokale (neni 22. pika 3.); b) i propozon organit kompetent mbikëqyrjen e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare (neni 22. pika 6); c) i propozon organeve kompetente masat dhe veprimet për të avansimin e përkthimit të dispozitave ligjore në gjuhët e pakicave kombëtare që janë në përdorim zyrtar (neni 22. pika 7); d) merr masa dhe aktivitete për avansimin e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare (neni 22. pika 8).

Kompetencat e Këshillit kombëtar në lidhje me emërtimet topografike kanë të bëjnë kryesisht me të drejtën e përcaktimit të emërtimeve tradicionale të njësisë të vetëqeverisjes lokale, vendbanimeve dhe emërtimeve të tjera gjeografike në gjuhën e pakicës kombëtare, nëse në territorin e njësisë së vetëqeverisjes lokale ose të vendbanimit gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar (neni 22. pika 1) dhe i propozon organeve kompetente vendosjen e këtyre emërtimeve (neni 22. pika 2).

Përveç ligjeve të mësipërme, përdorimi zyrtar i gjuhëve dhe alfabeveve rregullohet nga një numër i madh i të ashtuquajturave ligjeve sektoriale.

Korniza ndërkombëtare ligjore

Karta Evropiane për gjuhët rajonale apo të pakicave - Qëllimi kryesor i Kartës është mbrojtja e gjuhëve historike, rajonale dhe minoritare në Evropë, dhe kështu edhe ruajtjen dhe avansimin e traditës dhe llojllojshmërisë kulturore në Evropë. *Karta* parasheh një sërë masash për

përdorimin e gjuhëve në fushën e arsimit, gjyqësorit, administratës, medias, por edhe në jetën shoqërore dhe ekonomike. Karta në tërësi kontribuon në realizimin e së drejtës për përdorimin zyrtar të gjuhëve së pakicave kombëtare.

Me aktin e ratifikimit, mbi përdorimin e gjuhëve të pakicave në territoret administrative të shtetit ku jetojnë numri i folësve të gjuhëve të pakicave që justifikon zbatimin e masave të veçanta, Republika e Serbisë është obliguar se do të mundësojë atyre që të paraqesin kërkesat e tyre me gojë ose me shkrim në gjuhët e tyre (neni 10. paragrafi 1., pikat a (IV) dhe (V).

Sa i përket përdorimit të gjuhëve të pakicave para organeve lokale dhe regjionale, Republika e Serbisë është e obliguar se do aprovojë ose inkurajojë: a) shtetasit që flasin gjuhën e pakicave të dorëzojnë kërkesat gojë ose me shkrim në ato gjuhë; b) organet regjionale dhe vendore të publikojnë dokumentet zyrtare në gjuhët përkatëse të minoriteteve; c) përdorimin e formës tradicionale të emërtimeve të vendbanimeve në gjuhët regjionale ose minoritare, së bashku me emërtimin në gjuhën zyrtare të shtetit (neni 10, paragrafi 2. pikat b, c, d, dhe g).

Sa i përket përdorimit të gjuhëve të pakicave në punën e shërbimeve publike në territorin në të cilin përdoren ato gjuhë, Serbia është obliguar që të mundësojë atyre që përdorin gjuhët regjionale ose të pakicave të paraqesin kërkesat në këto gjuhë (neni 10, paragrafi 3, pika c). Për të mundësuar ushtrimin e përdorimit zyrtar të gjuhëve regjionale ose të pakicave para organeve të administratës dhe shërbimit publike, Republika e Serbisë është obliguar që, në masën në të cilë është e mundshme, të përmbush kërkesat e punonjësve në shërbimit publike të cilët njohin ndonjë gjuhë rajonale ose të pakicës të emërohen në territorin në të cilin përdoren këto gjuhë (Neni 10, paragrafi 4, pika c). Republika e Serbisë ka pranuar masën nga neni 10. paragrafi 5., e cila parashikon që shtetet që marrin përsipër të lejojnë përdorimin ose miratimin e emrave familjare në gjuhët regjionale ose të pakicës, me kërkesë të të interesuarve.

Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare - çështjen e përdorimit zyrtar të gjuhës së pakicave kombëtare Konventa kornizë e rregullon në nenin. 10. dhe 11. Neni 10 paragrafi 1 njeh të drejtën e pjesëtarëve të pakicës kombëtare që të përdorin lirisht dhe pa ndërhyrje gjuhën e tyre, qoftë privatisht apo publikisht. Detyrimi i shtetit, që rrjedh nga dispozita, konsiston kryesisht në mosveprimin, pasi që shteti nuk

guxon të ndërhyjë në përdorimin e gjuhës së pakicës kombëtare. Detyrimi për veprim, në aspektin e përkrahjes apo të avansimit, nuk është e rregulluar në mënyrë eksplicite me normë, dhe se veprimi i shtetit ka të bëjë me obligimin e tij që të parandaloj ndërhyrjen nga palët e treta.

Përdorimi i gjuhëve të pakicave gjatë komunikimit me organet shtetërore është e rregulluar në nenin 10. paragrafi 2. Kështu që, me normë nuk janë përfshira të gjitha organet shtetërore, por vetëm organet e administratës.

Emri personal

E drejta në emër personal është një nga të drejtat e ngritura në nivelin e të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutë. Kushtetuta e Serbisë, në nenin 37. paragrafi 3., proklamoi se zgjedhja dhe përdorimi i emrit personal dhe i emrave të fëmijëve të tyre është i lirë. Për pjesëtarët e pakicave kombëtare, Kushtetuta, në nenin 79. paragrafin 1. përmban garancinë shtesë për të drejtën e përdorimit të emrit dhe mbiemrit në gjuhën e tyre.

Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare në nenin 9 parasheh që pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë të zgjedhin dhe përdorin lirisht emrin personal dhe emrat e fëmijëve të tyre, si në regjistrimin e emrit të tyre personal në të gjitha dokumentet zyrtare, evidencat zyrtare dhe regjistrat e të dhënave personale në gjuhën dhe drejtshkrimin e pjesëtarëve të pakicës kombëtare.

Me ligjin e njejtë në nenin 11. paragrafi 4. parashihet se përdorimi zyrtar i gjuhëve dhe shkrimeve të pakicave kombëtare nënkupton lëshimin e dokumenteve zyrtare dhe mbajtjen e evidencave zyrtare dhe regjistrave të të dhënave personale në gjuhët e pakicave kombëtare si dhe pranimin e këtyre dokumenteve zyrtare, si të vlefshme.

Ligji për librat amzë përcakton në nenin 17. se emri personal i fëmijës, prindit, bashkëshortëve dhe të të vdekurit shënohen në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, ndërsa pjesëtarët e pakicës kombëtare kanë të drejtë të regjistrojnë emrin personal në gjuhën dhe drejtshkrimin e pakicës kombëtare, çka nuk përjashton regjistrimin paralel të emrit personal edhe në gjuhën serbe me shkrim cirilik.

Udhëzimi për udhëheqje e librave amzë dhe formularët e librave amzë më hollësisht e rregullon atë se emri i pjestarit që i përket pakicës kombëtare shënohet në librin amzë në gjuhën dhe alfabetin e pakicës

kombëtare, pas regjistrimit në gjuhën serbe me shkrim cirilik, nën të në të njejtën formë dhe madhësi të shkronjave.

Me të njejtin udhëzim, në pikën 137., thuhet se në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat me statut është vendosur se gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar, formularët e çertifikatave nga librat amzë nga pika 134. - 136. i këtij udhëzimi botohen edhe në dy gjuhë, në gjuhën serbe, në shkrimin cirilik dhe në gjuhën dhe shkrimin e asaj pakice kombëtare gjuha e të cilës është në përdorim zyrtar. Teksti i rubrikës në gjuhën dhe shkrimin e pjesëtarëve të pakicës kombëtare shkruhet nën tekstin në gjuhën serbe, në të njejtën formë dhe madhësi të shkronjave.

Ligji për letërnjoftimin në nenin 9. paragrafi 3. parasheh që të dhënat mbi mbiemrin dhe emrat të shkruhen në formularin e letërnjoftimit në formën burimore, ashtu si që janë shenuar në çertifikatën e lindjes, ku këto të dhëna të pjesëtarët e pakicave kombëtare shkruhen paralelisht edhe sipas drejtshkrimit dhe shkrimit serb.

Ligji për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, në nenin 18a. parasheh që pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë të zgjedhin dhe përdorin lirisht emrin personal dhe emrat e fëmijëve të tyre, si dhe regjistrimin e këtyre emrave personal në të gjitha dokumentet zyrtare, evidencat zyrtare dhe regjistrat e të dhënave personale sipas gjuhës dhe drejtshkrimit të pjesëtarit të pakicës kombëtare.

Rregullorja mbi procedurën e lëshimit të çertifikatës së lindjes dhe formularit të regjistrimit të lindjes së fëmijës në institucionet shëndetësore në pjesën që rregullon deklarimin për emrin personal të fëmijës është paraparë regjistrimi i emrit dhe mbiemrit personal sipas gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare.

CIP – Каталогизација у публикацији
Народна библиотека Србије, Београд

342.725(=18)(497.11)

81'272(497.11)

RAPORT i veçantë i Mbrojtësit të qytetarëve për përdorimin
zyrtar të gjuhës dhe shkrimt shqip / [redaktor Robert Sepi].

– 1. bot. – Beograd : Mbrojtësi i qytetarëve, 2018 (Beograd :
Gazeta zyrtare). – 25 str. ; 21 cm

Tirazh 100. – Napomene i bibliografske reference uz tekst.

ISBN 978-86-87945-44-9

а) Албански језик – Службена употреба – Србија

COBISS.SR-ID 259018252
